

## Vendim nr. 208 datë 30.09.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Sandër Beci,	Anëtar
Illir Toska,	Anëtar

në datën 30.09.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 14 (E) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** ET'HEM LLANI, përfaqësuar nga avokatja Kristina Marku, me akt përfaqësimi të lëshuar në mjediset e IEVP, Shkodër.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 2528, datë 29.09.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 2491, datë 26.11.2018 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2024-220, datë 08.02.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.  
Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 17, 27, 28, pika 3, 42, pika 2, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 5 dhe 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. 6301 të vitit 2015 në ngarkim të shtetasve Se.Ll., Sa.Ll., Et'hem Llani, K.Ll. e M.P., të dyshuar për kryerjen e veprave penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, të kryer në bashkëpunim, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe i municionit” në banesë, “Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta”, “Veprime që pengojnë në zbulimin e së vërtetës”, të parashikuara respektivisht nga nenet 283, paragrafi 2, 278, paragrafët 2 dhe 4, 279, paragrafi 1 dhe 301 të Kodit Penal (KP). Kërkuesi është akuzuar në vijim për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 283, paragrafi i dytë, i KP-së, të kryer në bashkëpunim. Në përfundim të hetimeve, prokuroria ka vendosur dërgimin e çështjes për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2. Me vendim të ndërmjetëm, në seancën gjyqësore të datës 20.06.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka vendosur të veçojë çështjen e kërkuesit dhe të vazhdojë, përmes procedurës së gjykimit të shkurtuar, shqyrtimin e çështjes për të pandehurit e tjerë, për të cilët ka vendosur me vendimin nr. 2841, datë 21.09.2016, i cili është ndryshuar me vendimin nr. 234, datë 22.02.2017 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

3. Për sa i përket kërkuesit, ai është gjykuar në mungesë me ritin e zakonshëm dhe në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. 2528, datë 29.09.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur deklarimin e tij fajtor për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, të kryer në bashkëpunim, dhe dënimin me 8 vjet e 6 muaj burgim.

4. Kërkuesi ka ushtruar ankim kundër vendimit të gjykatës së rrethit, duke pretenduar, ndër të tjera, se vepra penale nuk është kryer prej tij, prokuroria dhe gjykatat nuk kanë bërë vlerësim të drejtë të provave, provat janë marrë në kundërshtim me dispozitat procedurale penale, gjykata e rrethit nuk ka pranuar kërkesën e mbrojtësve për riçeljen e hetimit gjyqësor, mbrojtja e realizuar nuk ka qenë efektive. Me vendimin nr. 2491, datë 26.11.2018, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke e gjetur atë të drejtë si për sa i përket fajësisë së kërkuesit, ashtu edhe për sa i përket caktimit të masës e llojit të dënimit.

5. Kërkuesi ka ushtruar rekurs ndaj vendimeve të lartpërmendura, duke pretenduar, krahas pretendimeve të parashtruara në ankimin përpara gjykatës së apelit, edhe se nuk ka qenë i pranishëm gjatë gjykimit në apel dhe nuk është përfaqësuar nga mbrojtës, se gjykata e apelit nuk ka marrë parasysh pretendimet e tij, si dhe se ajo gjykatë nuk e ka shtyrë seancën me qëllim që t’i jepte avokatit të tij kohën e nevojshme për t’u njohur me aktet. Me vendimin nr. 00-2024-220, datë 08.02.2024, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit.

6. Në datën 12.06.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, i cili pas plotësimit, sipas parashikimeve të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 15.07.2024.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmblodhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

7.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të:*

7.1.1. *Parimit të prezumimit të pafajësisë*, pasi nuk ka asnjë provë që vërteton kryerjen prej tij të veprës penale, ekzistencën e bashkëpunimit ose që e lidh atë me lëndën narkotike të sekuestruar. Nga deklarimet e shtetasve Se.Ll., N.Ll., Sa.Ll. dhe K.Ll., si dhe nga të dhënat e marra nga ALUIZNI, Tiranë, rezultojnë e provuar se banesa në të cilën është gjetur lëndë narkotike nuk është në emër të tij. Deklarimet e dëshmitarëve F.S. dhe M.P. kanë kundërthënë, çka vë në dyshim bazueshmërinë e tyre. Po sipas deklarimeve të këtyre shtetasve, ata kanë komunikuar në telefon me kërkuesin, çka e bënte të nevojshme marrjen e tabulateve telefonike, si provë vendimtare për përcaktimin e fajësisë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk ka argumentuar për veprimet konkrete të kryera nga kërkuesi ose lidhjen logjike mes tyre, por ka marrë për bazë deklarimet e njërit prej të bashkëpandehurve. Për veprat penale, me vendimin nr. 2841, datë 21.09.2016, kjo gjykatë ka deklaruar fajtorë dhe ka dënuar të pandehurit Se.Ll., Sa.Ll. dhe K.Ll. Gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit pa marrë parasysh pretendimet e tij, pa vlerësuar shkeljet e rënda procedurale të gjykatës së rrethit dhe duke mbivlerësuar provat, ndërsa Gjykata e Lartë ka vendosur në kundërshtim me KP-në dhe Kodin e Procedurës Penale (*KPP*), pasi akuzat janë të pabazuara dhe nuk provohen tej çdo dyshimi të arsyeshëm.

7.1.2. *Së drejtës për t'u mbrojtur*, pasi hetimi gjyqësor në gjykatën e rrethit ka përfunduar pa praninë e tij ose të avokatit të zgjedhur prej tij. Gjykata, pa vendim, ka vendosur t'i caktojë avokat kryesisht, ndërkohë që ka deklaruar se ai kishte prokurë të caktuar nga familjarët. Kërkuesi dhe përfaqësuesi i tij me prokurë nuk janë njoftuar për këtë. Kërkesa e mbrojtësit, e paraqitur në seancën e datës 28.09.2017, për riçeljen e seancës gjyqësore me qëllim

marrjen e provave të reja, nuk është pranuar nga gjykata e rrethit. Kjo gjykatë nuk ka ushtruar të drejtat që i janë njohur asaj nga neni 367 i KPP-së, por është mjaftuar me provat e paraqitura në gjykim nga prokuroria. Në kundërshtim me nenin 50 të KPP-së, gjykata e apelit nuk ka pranuar kërkesën e mbrojtësit për shtyrjen e seancës gjyqësore me qëllim që të njihej me aktet e dosjes, duke mos i dhënë kohën e nevojshme për realizimin e mbrojtjes. Po kështu, ajo nuk ka caktuar avokat kryesisht për të siguruar zhvillimin e seancës së ardhshme gjyqësore. Kërkuesi nuk ka qenë i pranishëm gjatë gjykimit të çështjes në seancë në këtë gjykatë, duke mos u përmbushur realizimi i mbrojtjes. Gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit pa marrë parasysh asnjë pretendim të tij dhe pa vlerësuar saktë provat e paraqitura në gjykatën e rrethit.

7.1.3. *Së drejtës për mbrojtje efektive*, pasi në gjykimin e çështjes në gjykatën e rrethit mbrojtësit nuk kanë ushtruar të drejtën për të kërkuar gjykimin e çështjes përmes ritit të gjykimit të shkurtuar, e drejtë kjo njohur atyre përmes prokurës. Po kështu, ata nuk kanë ushtruar të drejtën për të paraqitur argumente në mbrojtje të tij; për të marrë prova të reja, të pamarra nga organi i akuzës, të tilla si të dhëna për pronësinë e banesës, tabulatet telefonike nga kompanitë celulare ose transkriptet e bisedave telefonike të bëra prej tij; për të pyetur dëshmitarë; për të kryer ekspertime; për të kundërshtuar provat ose veprimet procedurale të kryera në kundërshtim me përcaktimet e KPP-së. Mbrojtësit nuk e kanë informuar për gjykimin në shkallë të parë.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkuesit

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr.

8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

10. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

11. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës.

12. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se vënia në dispozicion të palëve e vendimeve të gjykatës ua bën të njohura atyre arsyet e vendimmarrjes, duke u dhënë mundësinë të ankohen nëse e shohin të arsyeshme. Për rrjedhojë, si datë e fillimit të afatit ligjor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, që i korrespondon momentit të konstatimit të cenimit, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, është data e marrjes dijeni efektive për vendimin gjyqësor të marrë në ushtrim të mjetit të fundit ankimor. Si rregull, kjo datë është ajo e shpalljes së vendimit gjyqësor të arsyetuar në prani të palës, kurse kur vendimi gjyqësor nuk shpallet i arsyetuar ose kur pala nuk është e pranishme, data e marrjes dijeni konsiderohet ajo e njoftimit shkresor ose elektronik të tij. Në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimet nr. 49, datë 20.06.2024; nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Duke zbatuar këtë qasje në rastin konkret, Kolegji vëren se nga materialet e vëna në dispozicion nga kërkuesi së bashku me ankimin kushtetues individual, si dhe nga informacioni i marrë nga Gjykata e Lartë rezulton se vendimi gjyqësor i kundërshtuar i kësaj gjykate, i marrë në dhomën e këshillimit (pa praninë e palëve), është publikuar në faqen zyrtare

të saj në datën 10.06.2024 dhe i është njoftuar në rrugë elektronike avokates së kërkuesit në të njëjtën datë, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 12.06.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

14. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, Kolegji vëren në kërkesën drejtuar Gjykatës kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të prezumimit të pafajësisë, së drejtës për t'u mbrojtur dhe së drejtës për mbrojtje efektive. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës së mbrojtjes, në lidhje me argumentin se gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit, pa marrë parasysh asnjë pretendim të tij dhe pa vlerësuar saktë provat e paraqitura në gjykatën e rrethit, Kolegji vlerëson se ato kanë të bëjnë me vlerësimin e fakteve dhe provave, çka nuk i përket juridiksionit kushtetues, ndërsa në lidhje me pretendimet për mosvënien e tij në djeni nga mbrojtësit për gjykimin e çështjes në gjykatën e rrethit, Kolegji çmon se kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë argument kushtetues në mbështetje të tyre. Ndërkohë, për sa u përket pretendimeve të tjera, Kolegji vlerëson se ato *prima facie* përfshihen në juridiksionin kushtetues, ndaj do t'i analizojë në vijim.

#### *B. Për pretendimin e cenimit të parimit të prezumimit të pafajësisë*

15. Kërkuesi ka pretenduar se nuk ka asnjë provë që vërteton kryerjen prej tij të veprës penale, që e lidh atë me lëndën narkotike të sekuestruar ose ekzistencën e bashkëpunimit. Banesa në të cilën është gjetur lënda narkotike nuk është në emër të tij. Deklarimet e dëshmitarëve jo vetëm kanë kundërthënë, por kërkonin edhe marrjen e provave të reja në gjykim. Gjykata e rrethit nuk ka argumentuar për veprimet konkrete të kryera nga kërkuesi ose lidhjen logjike mes tyre, por ka marrë për bazë deklaratimet e njërit prej të bashkëpandehurve. Me vendim të saj është vendosur deklarimi fajtorë dhe dënimi i të bashkëpandehurve të tjerë. Po sipas kërkuesit, gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit pa marrë parasysh pretendimet e tij, pa vlerësuar shkeljet e rëndësishme procedurale të gjykatës së rrethit dhe duke mbivlerësuar provat, ndërsa Gjykata e Lartë ka vendosur në kundërshtim me KP-në dhe KPP-së, pasi akuzat janë të pabaza dhe nuk provohen tej çdo dyshimi të arsyeshëm.

16. Parimi i prezumimit të pafajësisë parashikohet në nenin 30 të Kushtetutës, sipas të cilit kushdo quhet i pafajshëm, përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Sipas këtij parimi gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, barra e provës i takon palës akuzuese, çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza. Asnjë

dënim ose masë që barazohet me të nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Gjykatat janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime ose dyshime (*shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*)

17. Po sipas Gjykatës, është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrarisht, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në rastin konkret, Kolegji vëren se nga materialet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të shqyrtimit të kërkesës rezulton se kërkuesi është akuzuar nga prokuroria për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 283, paragrafi 2, dhe 25 të KP-së. Akuza penale në ngarkim të tij është mbështetur, ndër të tjera, edhe në një sërë provash të tilla si: raporti i mbikëqyrjes i ndihmësspecialistëve të seksionit të hetimit të krimit të Komisarariatit të Policisë nr. 5, Tiranë, sipas të cilit rezultonin informacione të marra në rrugë operative se kërkuesi ushtronte veprimtarinë kriminale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve së bashku me vëllezërit e tij dhe se banonte në banesën ku më pas është gjetur lënda narkotike e sekuestruar; procesverbali i datës 01.08.2015 për marrjen e të dhënave nga shtetasi M.P., si person që kishte dijeni për veprën penale, sipas të cilit rezultonte se kërkuesi merrej me shitjen e heroinës; procesverbali i së njëjtës datë për marrjen e të dhënave nga i njëjti shtetas, si person ndaj të cilit zhvilloheshin hetime, sipas të cilit rezultonte se M.P. kishte blerë edhe herë të tjera heroinë nga kërkuesi; deklaratimet e këtij shtetasi në seancën e datës 02.03.2017, gjatë gjykimit të çështjes nga gjykata e rrethit; procesverbalin e datës 01.08.2015 mbi deklaratimet e shtetasit K.L., si person ndaj të cilit zhvilloheshin hetime, sipas të cilit rezultonte se shitja e heroinës bëhej prej tij për llogari të kërkuesit, i cili e paguante për çdo shitje të realizuar; procesverbalet e marrjes së të dhënave nga nëna e babai i kërkuesit, si dhe nga shtetasi K.L., sipas të cilëve rezultonte se kërkuesi jetonte në të njëjtën banesë me ta, së bashku me vëllezër të tjerë; procesverbali i kontrollit të vendeve i datës 01.08.2015, sipas të cilit në banesë ishte gjetur edhe pasaportë në emër të

kërkuesit, me pjesën e poshtme të prerë (*shih faqet nr. 27, 29, 33, 193, 196, 198, 200, 203, 204 dhe 314 të dosjes hetimore*).

19. Duke pasur parasysh të dhënat e dosjes hetimore, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vlerësuar se nga provat e mbledhura gjatë hetimit dhe gjykimit të çështjes së kërkuesit provohej përtej çdo dyshimi të arsyeshëm kryerja, në bashkëpunim, e veprës penale nga kërkuesi, ndaj pretendimet e mbrojtjes se vepra penale nuk ishte kryer prej tij ishin të pabazuara (*shih faqet 5-9 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*). Vendimi i kësaj gjykate është vlerësuar i drejtë nga gjykata e apelit, si për sa i përket fajësisë së kërkuesit, ashtu edhe caktimit të masës dhe llojit të dënimit (*shih faqet 5-6 të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë*). Në vijim, ligjshmëria e vendimmarrjeve të gjykatave më të ulëta është analizuar edhe nga Gjykata e Lartë, e cila ka vlerësuar se disa prej pretendimeve të ngritura në rekurs kishin të bënin me çështje të vlerësimit të provave, çka dilte përtej juridiksionit tërësisht ligjor të saj, ndërsa pretendimet për prezumimin e pafajësisë kishin marrë përgjigje të plotë në arsyetimin e gjykatës së apelit, e cila i kishte analizuar ato në raport me provat dhe faktet e çështjes (*shih paragrafët 15 dhe 24 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

20. Në analizë të vendimmarrjeve të lartpërmendura, Kolegji vlerëson se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë përcaktuar në mënyrë të qartë faktet e çështjes në drejtim të përcaktimit të përgjegjësisë ligjore të kërkuesit për veprimet e kryera në kundërshtim me legjislacionin penal, si dhe kanë analizuar të gjitha provat e administruara gjatë fazës hetimore dhe gjatë gjykimit të çështjes, duke dhënë përgjigje të arsyetuar në lidhje me provat në të cilat kanë mbështetur vendimmarrjet e tyre. Po kështu, konkluzionet e arritura nga gjykatat për fajësinë e kërkuesit janë mbështetur në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, pas shqyrtimit të plotë të çështjes dhe pas formimit të bindjes se fajësia e tij provohej përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Vendimmarrjet e gjykatave nuk rezultojnë të tilla që vënë në dyshim garantimin prej tyre të parimit të prezumimit të pafajësisë gjatë shqyrtimit të çështjes së kërkuesit. Në këto kushte, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin nga gjykatat e zakonshme të këtij parimi është haptazi i pabazuar.

### *C. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së mbrojtjes*

21. Kërkuesi ka pretenduar se hetimi gjyqësor në gjykatën e rrethit ka përfunduar pa praninë e tij ose të avokatit të zgjedhur prej tij. Gjykata, pa vendim, ka vendosur t'i caktojë avokat kryesisht, ndërkohë që ka deklaruar se ai kishte prokurë të caktuar nga familjarët. As ai dhe as përfaqësuesi i tij me prokurë nuk janë njoftuar për këtë. Kërkesa e mbrojtëses për riçeljen e seancës gjyqësore me qëllim marrjen e provave të reja nuk është pranuar nga gjykata e rrethit.



Kjo gjykatë nuk ka ushtruar të drejtat që i janë njohur asaj nga neni 367 i KPP-së, por është mjaftuar me provat e paraqitura në gjykim nga prokuroria. Po sipas kërkesit, në kundërshtim me nenin 50 të KPP-së, gjykata e apelit nuk ka pranuar kërkesën e mbrojtësit për shtyrjen e seancës gjyqësore me qëllim që të njihej me aktet e dosjes, duke mos i dhënë kohën e nevojshme për realizimin e mbrojtjes. Ajo nuk ka caktuar avokat kryesisht për të siguruar zhvillimin e seancës së ardhshme gjyqësore. Kërkuesi nuk ka qenë i pranishëm gjatë gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit, duke mos u përmbushur realizimi i mbrojtjes.

22. Gjykata ka theksuar se e drejta e mbrojtjes duhet të jetë reale dhe efektive dhe jo vetëm teorike dhe se ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por, përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të drejtë t'i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, në respektim të parimit të barazisë së armëve, i cili synon realizimin e një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, çka ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi (*shih vendimet nr. 25, datë 10.06.2011; nr. 23, datë 23.07.2009; nr. 19, datë 18.09.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se gjatë fazës hetimore, në mbështetje të nenit 141, pika 1, të KPP-së, për mbrojtjen e të drejtave të kërkuarit prokuroria ka caktuar si mbrojtës kryesisht avokatin I.M. (*shih faqen 287 të dosjes hetimore*). Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, në seancën e datës 20.06.2016, për mbrojtjen e interesave të kërkuarit Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur caktimin kryesisht të avokatit E.H., kjo për shkak se kërkuesi nuk ishte i pranishëm në gjykim për deklarimin e mbrojtësit, ndërsa avokati I.M. i caktuar më parë ishte zgjedhur nga bashkëpandehurit e tjerë (*shih procesverbalin e seancës së datës 20.06.2016, faqja 4 dhe procesverbalin e seancës së datës 29.09.2016, faqja 1*). Në vijim, me prokurën e posaçme të datës 20.10.2016, kërkuesi ka caktuar avokatët I.M. dhe Z.Q. për ta mbrojtur atë gjatë gjykimit të çështjes deri në Gjykatën e Lartë, ndërsa me prokurën e datës 19.07.2017, i vëllai ka caktuar si mbrojtëse të kërkuarit avokaten K.M., përfaqësuese e tij edhe në këtë Gjykatë, si dhe avokaten I.S. Seancat gjyqësore në gjykatën e rrethit rezultojnë të jenë zhvilluar në vijim në prani të avokatit I.M. Në kushtet kur ky mbrojtës nuk është paraqitur pa shkak të arsyeshëm në gjykim, në seancën e datës 16.03.2017 gjykata ka vendosur zëvendësimin e tij me avokaten e caktuar kryesisht D.Ç., ndërsa në seancën e datës 21.03.2017 ka vendosur revokimin e vendimit të saj për caktimin e kësaj avokateje dhe ricaktimin e avokatit I.M. për përfaqësimin e kërkuarit. Në vijim kërkuesi është përfaqësuar në gjykim herë nga avokati I.M., herë nga Z. Q. dhe herë nga avokatja D.Ç. Në seancën e datës 27.07.2017 për paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare, është bërë zëvendësimi i kësaj të fundit me avokaten

e zgjedhur nga familjarët, I.S., dhe në kushtet e mosparaqitjes së saj, në seancën e datës 14.09.2017 është bërë zëvendësimi i saj me avokaten e caktuar kryesisht K.Ç. Kjo e fundit është zëvendësuar sërish në seancën e datës 28.09.2017 me avokaten K.M.

24. Ndërkohë, gjatë gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit, avokatja K.M. nuk është paraqitur në seancën e datës 07.11.2018, për shkak të pjesëmarrjes së saj në tjetër gjykim, ndërsa në seancën e datës 12.11.2018 gjykata ka konstatuar mosparaqitjen e kërkuesit, si dhe zgjedhjen prej tij të avokatit Gj.H., me deklaratë me shkrim të lëshuar nga ambientet e burgut. Në kushtet kur dhe ky i fundit nuk ishte i pranishëm në seancë, gjykata ka vendosur të caktojë kryesisht si përfaqësuese të kërkuesit avokaten V.P., si dhe njoftimin e saj e të avokatëve K.M. e Gj.H. për zhvillimin e seancës së radhës në datën 26.11.2018. Në seancën e kësaj date, avokati Gj.H. ka kërkuar shtyrjen e saj, me qëllim që t'i jepej mundësia të njihej me aktet e dosjes, si rrjedhojë e pamundësisë për t'u njohur me to për arsye objektive. Sipas tij, avokatja K.M. ishte ish-bashkëshortja e tij dhe me të nuk kishte më marrëdhënie. Kërkesa e avokatit për shtyrjen e seancës është rrëzuar nga gjykata me arsyetimin se ai ka pasur kohën e nevojshme në dispozicion për realizimin e mbrojtjes (*shih procesverbalin e seancës së gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit të datës 26.11.2018, faqja 31 e dosjes gjyqësore*). Në vijim, pasi ka dëgjuar pretendimet e mbrojtësit Gj.H., i cili ka kërkuar kthimin e çështjes për rishqyrtim, si rrjedhojë e zhvillimit të gjykimit nga gjykata e rrethit në mungesë të kërkuesit, si dhe pretendimet e prokurorisë, e cila ka kërkuar lënien në fuqi të vendimit të kësaj të fundit, në përfundim të gjykimit gjykata e apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

25. Ndërkohë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i ka vlerësuar të pabazuara pretendimet e ngritura nga kërkuesi në rekurs në lidhje me mospranimin e kërkesës së mbrojtëses për riçeljen e hetimit me qëllim marrjen e provave të reja, si dhe për mosdhënien mbrojtësit të kohës së nevojshme për t'u njohur me dosjen gjatë gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit. Sipas këtij kolegji, neni 427 i KPP-së njihte të drejtën e gjykatës për riçeljen e gjykimit dhe marrjen e provave të reja vetëm nëse ajo nuk mund të vendoste në gjendjen që ishin aktet. Gjykata e apelit kishte vepruar në përputhje me ligjin procedural penal, duke vlerësuar kërkesën e mbrojtësit në raport me procesin në tërësi, gjendjen e akteve dhe domosdoshmërinë e përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor dhe qëndrimi i saj ishte në përputhje edhe me jurisprudencën kushtetuese për sa i takon zbatimit të kësaj dispozite ligjore. Po sipas Kolegjit Penal, gjykata e apelit kishte vlerësuar drejt edhe faktin se avokati i të pandehurit kishte pasur kohën e mjaftueshme për t'u njohur me aktet e dosjes gjyqësore, ndërkohë që sjellja e tij nuk ishte në përputhje me ligjin për profesionin e avokatit dhe Kodin Etik të Avokatit. Po kështu,

Kolegji Penal ka vlerësuar se, në kushtet kur kërkuesi kishte mbetur pa mbrojtës, për arsye të mosmarrjes përsipër të mbrojtjes ose mosparaqitjes së mbrojtësit pa shkak në gjykim, zëvendësimi i mbrojtësve gjatë gjykimit ishte bërë nga gjykatat në përputhje me ligjin dhe të drejtën e tij për t'u mbrojtur (*shih vendimin e Gjykatës së Lartë, paragrafët 19-22*).

26. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se, në përputhje me detyrimet kushtetuese dhe ligjore, gjykatat kanë marrë të gjitha masat e nevojshme për përfaqësimin e kërkuesit me avokat të zgjedhur prej tij ose të caktuar kryesisht, në garantim të së drejtës së tij mbrojtjes gjatë procedimit dhe gjykimit penal. Gjatë gjykimit rezulton se, përmes mbrojtësve të tij, të caktuar kryesisht në përputhje me parashikimet ligjore ose të zgjedhur prej tij, kërkuesit i janë dhënë mundësi të barabarta për paraqitjen e pretendimeve të tij, në kushte të njëjta me organin e ndjekjes penale dhe në asnjë seancë nuk rezulton që gjykimi të jetë zhvilluar në mungesë të përfaqësuesve ligjorë. Në këtë këndvështrim, mbrojtja e kërkuesit rezulton të ketë qenë reale dhe në garantim të parimit të barazisë së armëve, ndaj Kolegji çmon se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës së mbrojtjes janë haptazi të pabazuara.

#### *Ç. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për mbrojtje efektive*

27. Kërkuesi ka pretenduar se në gjykimin e çështjes në gjykatën e rrethit mbrojtësit nuk ushtruar të drejtën për të kërkuar gjykimin e shkurtuar; nuk kanë paraqitur argumente në mbrojtje të tij ose kërkesa për të marrë prova të reja, të cilat nuk ishin marrë nga organi i akuzës, të tilla si të dhëna për pronësinë e banesës, tabulatet telefonike nga kompanitë celulare ose transkriptet e bisedave telefonike të bëra prej tij; nuk kanë marrë në pyetje dëshmitarët; nuk kanë kërkuar kryerjen e ekspertimeve; nuk kanë kundërshtuar provat ose veprimet procedurale të kryera në kundërshtim me përcaktimet e KPP-së (*KPP*), në cenim të së drejtës për mbrojtje efektive.

28. Në drejtim të së drejtës për mbrojtje efektive, në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6, pika 3, shkronja “c”, të KEDNJ-së, thjesht “caktimi” i një avokati nuk siguron ndihmë efektive dhe se autoritetet kanë detyrimin të sigurohen që ai të përmbushë detyrat e tij. Përgjegjësia e shtetit mund të lindë kur një avokat thjesht nuk vepron në favor të të akuzuarit ose kur ai nuk përmbush një kërkesë thelbësore procedurale që nuk mund të barazohet thjesht me një linjë të padrejtë mbrojtjeje ose një defekt të thjeshtë argumentimi. Për shkak të pavarësisë së profesionit të avokatit, sjellja e mbrojtësit është në thelb një çështje midis të pandehurit dhe përfaqësuesit të tij dhe shtetit i kërkohet të ndërhyjë vetëm nëse një dështim nga avokati për të ofruar përfaqësim efektiv është i dukshëm

ose vihet mjaftueshëm në vëmendje në ndonjë mënyrë tjetër (*shih vendimet nr. 45, datë 03.10.2023; nr. 34, datë 17.11.2022; nr. 35, datë 01.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Po sipas Gjykatës, mbrojtja nga një avokat i caktuar kryesisht, që i ofrohet individit në procesin penal, është pjesë e skemës së mbrojtjes së detyrueshme që ofrohet nga shteti konform nenit 49 të KPP-së, skemë e cila synon të sigurojë aksesin në drejtësi, mosdiskriminimin dhe cilësinë e shërbimit të mbrojtjes në funksion të procesit të rregullt, që në rastin e procesit penal materializohet në gjykimin e drejtë. Veprimtaria e mbrojtësit në kuadër të kësaj skeme ushtrohet duke përmbushur njëkohësisht edhe detyrimet që ai ka në bazë të ligjit për profesionin e avokatit, i cili përcakton edhe mbikëqyrjen e kësaj veprimtarie nga Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë. Në këtë pikëpamje, Gjykata ka theksuar se është përgjegjësi e të gjithë aktorëve të përfshirë në skemat e ndihmës juridike të garantojnë zbatimin efektiv të legjislacionit në fuqi, me të cilin synohet që edhe individit, në situata pamundësie për të zgjedhur mbrojtës ose kur mbrojtja është e detyrueshme, t'i respektohen të drejtat kushtetuese dhe dinjiteti njerëzor (*shih vendimin nr. 34, datë 17.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Në çështjen konkrete, nga materialet e dosjes gjyqësore Kolegji vëren se gjatë shqyrtimit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë, krahas pretendimeve të parashtruara në gjykim, avokati I.M., i caktuar fillimisht kryesisht nga gjykata dhe i emëruar më pas si mbrojtës nga vetë kërkuesi, ka paraqitur argumentet e tij ndaj akuzës së ngritur nga prokuroria. Kështu në parashtrimin hyrës dhe kërkesën për prova, mbrojtësi ka pretenduar, ndër të tjera, se vepra penale nuk ishte kryer nga kërkuesi, se banesa në të cilën ishte sekuestruar lënda narkotike nuk ishte në emër të tij dhe se nuk ekzistonte asnjë provë konkrete ose me dëshmitarë që e fajësonte atë. Në këto kushte, për qëllime të të provuarit të pafajësisë së kërkuesit, mbrojtësi ka kërkuar marrjen e një sërë provash të tjera, si dhe pyetjen e të pandehurve të tjerë, oficerëve të policisë gjyqësore e të shtetasve N.Ll. e F.S. Në vijim, ky mbrojtës ka paraqitur para gjykatës argumentet e tij për kundërshtimin e provave shkresore që janë kërkuar të merren nga prokuroria. Po kështu, në dosje rezultojnë të administruara edhe konkluzionet përfundimtare të paraqitura nga avokatja K.M., e cila, krahas pretendimeve të ngritura nga avokati I.M. ka pretenduar edhe pavlefshmërinë e një sërë akteve të dosjes hetimore, si rrjedhojë e mos hartimit të tyre në formën e kërkuar nga ligji ose mosnjohimit të tyre kërkuesit; mungesën e ekzistencës së marrëveshjes së bashkëpunimit, si dhe se mosarritjen e të provuarit të fajësisë së kërkuesit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (*shih faqet 67-78 dhe 83-94 të dosjes gjyqësore*).

31. Ndërkohë, ndonëse gjykata e apelit nuk rezulton të ketë arsyetuar në drejtim të pretendimeve të kërkuesit për cenimin e së drejtës për mbrojtje efektive, kjo mangësi rezulton të jetë riparuar në Gjykatën e Lartë. Ajo ka vlerësuar se, ndërkohë që zgjedhja e mbrojtësit

është një e drejtë që garantohet nga ligji procedural shqiptar, i përket mbajtësit të kësaj të drejte që ta ushtrojë atë rregullisht dhe në dobi të interesit të tij të ligjshëm, pasi marrëdhëniet mes të pandehurit dhe mbrojtësit të tij rregullohen nga vetë këto subjekte, të cilët vendosin edhe për mënyrën e realizimit të mbrojtjes ose qëndrimin ndaj akuzës. Gjykata nuk ndërhyr në mënyrën se si i pandehuri zgjedh të realizojë mbrojtjen e tij në një proces penal. Po sipas Kolegjit Penal, ligji nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë” dhe Kodi Etik i Avokatit përcaktojnë detyrimin e mbrojtësve që, në ushtrimin e profesionit të avokatit, të udhëhiqen nga parimet bazë të profesionalizmit, etikës, besnikërisë, integritetit dhe konfidencialitetit, duke i siguruar çdo klienti mbrojtje profesionale, të drejtë dhe efektive në funksion të realizimit me besnikëri të interesave të tij, si dhe sjelljen e avokatit me respekt, ndershmëri dhe integritet kundrejt gjykatës, në funksion të përfaqësimit e mbrojtjes të interesave të klientit të tij. Nga ana tjetër, fakti se i pandehuri nuk është dakord me vendimet gjyqësore ose nuk pajtohet me mënyrën e mbrojtjes së kryer nga mbrojtësit e zgjedhur prej tij, nuk do të thotë se atij i është cenuar e drejta e garantimit të një mbrojtjeje efektive (*shih paragrafët 16-17 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

32. Në këndvështrim të sa më lart, në rastin konkret, Kolegji çmon se, në kundërshtim nga sa pretendohet, mbrojtja e kërkuarit gjatë gjykimit të çështjes në gjykatën e rrethit nuk rezulton të ketë qenë joefektive. Kështu, në përputhje me standardet kushtetuese, avokatët e kërkuarit, të caktuar kryesisht ose të zgjedhur nga ai ose familjarët e tij, rezulton të kenë përmbushur të gjitha kërkesat procedurale, duke paraqitur pretendime në kundërshtim të akuzës së ngritur ndaj kërkuarit, duke kërkuar marrjen e provave për qëllime të realizimit të një mbrojtjeje efektive, si dhe duke marrë në pyetje të dëshmitarët. Mbrojtja nuk rezulton të ketë qenë joprofesionale ose në cenim të interesave të kërkuarit. Kështu, për sa u përket mbrojtësve të caktuar kryesisht, E.H., D.Ç. dhe K.Ç., gjatë gjykimit të çështjes në gjykatën e rrethit, seancat gjyqësore në të cilat këta përfaqësues ligjorë kanë marrë pjesë rezulton të jenë shtyrë nga gjykata. Për sa u përket avokatëve të tjerë, I.M., i caktuar fillimisht kryesisht nga gjykata dhe më pas i zgjedhur nga vetë kërkuari, I.S., Z.Q. dhe K.M., mbrojtja e realizuar prej tyre gjatë gjykimit të çështjes nga gjykata e rrethit nuk rezulton të ketë qenë në shkelje të dispozitave të ligjit për profesionin e avokatit ose Kodit Etik të Avokatit. Për më tepër, në këtë drejtim, nga materialet e depozituara nga kërkuari së bashku me ankimin kushtetues individual, nuk rezulton që ai t’i jetë drejtuar Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë, e cila përgjigjet për kontrollin e ushtrimit të profesionit të avokatit, me ankesë për mbrojtjen e realizuar nga përfaqësuesit e tij në gjykatën e rrethit. Në këto kushte, Kolegji çmon se pretendimet e kërkuarit për cenimin e së drejtës për mbrojtje efektive janë haptazi të pabazuara.

33. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

**PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.